

IOM office-specific Ref. No.:	
IOM Project Code:	
LEG Approval Code	MKD/LCOO/EC121/2018

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

ndërmjet

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

(përfaqësuar nga Ministri pa Resor i angazhuar për diasporën)

dhe

ORGANIZATËS NDËRKOMBËTARE PËR MIGRIM (IOM)

PËR BASHKËPIUNIM NË FUSHËN E DIAPORËS

13 Maj, 2019

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësuar nga Ministri pa resor i angazhuar për Diasporën ("Ministri"), dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim ("IOM") (në vijim referuar individualisht si "Palë" dhe përbashkët si "Palët"),

DUKE MARRË PARASYSH se qëllimet e Ministrit janë:

- a) Të krijojë lidhje bashkëpunimi ndërmjet shtetit dhe diasporës;
- b) Të nxisë bashkëpunim me ministritë tjerë që punojnë në çështje me interes të diasporës;
- c) Të sigurojë komunikim të vazhdueshëm me diasporën për çështje të ndryshme dhe takime të vendeve ku qëndrojnë përfaqësues të diasporës; dhe
- d) Të thellojnë bashkëpunimin ndërmjet shtetit dhe diasporës në katër fusha: aspekti politik dhe administrativ, ekonomik, arsimit dhe të rinjtë dhe kultura.

DUKE MARRË PARASYSH që IOM-i është i përkushtuar ndaj parimeve që migracioni i rregullt dhe human është në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë, vepron që: të ndihmojë në përmbushjen e sfidave të migrimit, të nxisë të kuptuarit më të mirë të çështjeve të migracionit, të inkurojë zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet migracionit dhe punon për të respektuar në mënyrë efektive të drejtave të njeriut dhe mirëqenies së migrantëve.

TË NDËRGJEGJSHËM për nevojën e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet Ministrit dhe IOM-it në çështje të interesit të përbashkët dhe me dëshirën që edhe më tej të forcohet bashkëpunim i tillë.

RANË DAKORD SI MË POSHTË:

NENI I

PARIMET E PËRGJITHSHME TË BASHKËPUNIMIT

1. Brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në përputhje me burimet në dispozicion, Ministri dhe IOM-i në bashkëpunim të ngushtë dhe do të zhvillojnë konsultime për çështje të interesit të përbashkët. Për këtë qëllim, Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur për konsultime të tilla kurdo që të jetë e nevojshme.
2. Ministri dhe IOM-i janë të pajtimit që aktivitetet që i referohen diasporës do të koordinohen, deri në shkallën e mundësive të dhëna, me përpjekjeve që të arrihet bashkëpunim maksimal dhe këtë e imponojnë interesat e përbashkëta, secila Palë mund të kërkojë bashkëpunim nga pala tjetër.
3. Secila Palë do të përpiqet, sa më shumë të jetë e mundur dhe në pajtim me instrumentet përbërëse dhe vendimet e organeve kompetente, t'i përgjigjet në mënyrë të favorshme kërkesave të tilla për bashkëpunim në përputhje me procedurat që bihen dakord bashkërisht.

NENI II

SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE DOKUMENTACIONI

1. Ministri dhe IOM-i janë bien dakord të shkëmbejnë informacionin dhe dokumentacionin e disponueshëm publikisht deri në shkallën më të gjerë të mundshme për çështje me interes të përbashkët.
2. Kur është e përshtatshme dhe në përputhje me kushtet e domosdoshme, informacionet dhe dokumentacioni për projekte dhe programe konkrete ose programe gjithashtu mund të shkëmbehen nëpërmjet Palëve me qëllim të arrihet veprim më i mirë komplementar dhe koordinim efektiv në mes të dyja Palëve.

NENI III

VEPRIME TË PËRBASHKËTA

1. Ministri dhe IOM-i, mund që përmes marrëveshjeve të posaçme, të vendosin që së bashku të veprojnë gjatë zbatimit të projekteve në interes të përbashkët. Marrëveshjet e veçanta do të definojnë mënyrat në të cilën secila prej Palëve do të merr pjesë dhe do të përcaktojnë shpenzimet të cilat do të mbulohen nga secila prej Palëve.
2. Ministri dhe IOM-i, kur do që konsiderojnë të nevojshme se është e nevojshme , mund të krijojnë komisione, komitete dhe trupa të tjerë teknik dhe këshillues për çështje me interes të përbashkët, detyrat e punës të së citit do të bien dakord reciprokisht në secilin rast të posaçëm.

NENI IV

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

Pa paragjykuar bashkëpunimin në fushat tjera, brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në përputhje me burimet në dispozicion, Palët bien dakord të marrin parasysh fushat në vijim për bashkëpunim për aktivitete të përbashkëta dhe bashkëpunim në:

- Përkrahje këshilluese për zhvillimin e politikave dhe dokumenteve strategjike për diasporën;
- Përkrahje në angazhimin efektiv të diasporës;
- Ndërtimin e kapaciteteve të aktorëve institucional të cilët kanë kompetenca për çështje lidhur me diasporën;
- Mbështetje për monitorimin e avancimit dhe matjes së rezultateve në fushën e angazhimit të diasporës;
- Mbledhje e përbashkët e mjeteve financiare për projekte; dhe,
- Punët tjera të ngjashme në koordinim dhe marrëveshje mes Palëve.

NENI V

BASHKËPUNIMI NË MES PALËVE

Ministri dhe Shefi Zyrës së Misionit të IOM-it në Shkup do të marrin masat e duhura për të siguruar bashkëpunimin efektiv ndërmjet Palëve. Kjo përfshinë bashkëpunimin e ngushtë në teren, në veçanti në lokacione ku janë përfshirë të dyja Palët.

NENI VI

ZBATIMI I MEMORANDUMIT

Ministri dhe Misioni i IOM-it në Shkup do të konsultohen rregullisht me njëri-tjetrin për çështje që i referohen këtij Memorandumi.

NENI VII

MARRËVESHJE SHITESË

Ministri dhe IOM-i mund të lidhin marrëveshje shtesë për qëllime të bashkëpunimit dhe koordinimit kur të jetë e nevojshme.

NENI VIII

KONFIDENCIALITETI

Të gjitha informacionet, duke përfshirë edhe informacionin personal do të jenë në dispozicion dhe në dijeni të Palëve lidhur me këtë Memorandum duhet të trajtohen si rreptësishtë konfidencial. Informacione personale nuk duhet t'i komunikohet palës së tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës në fjalë. Palët do t'i përmbahen Parimit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të IOM-it nëse mblidhen, pranohen, përdoren, barten ose rruhen çfarë do lloj informacione personale gjatë realizimit të këtij Memorandumi. Detyrimet e këtij neni do të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të afatit apo ndërprerjes së këtij Memorandumi.

NENI IX

PRONËSIA INTELKTUALE

Të gjitha të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejta të tjera pronësore, duke përfshirë por pa u kufizuar në patentat, të drejtave të autorit, markat tregtare dhe pronësia e të dhënave që dalin nga aktivitetet ose projekte në përputhje me këtë Memorandum do të garantohen si e drejtë ligjore e IOM-it, duke përfshirë, pa kufizuar të drejtat e përdorimit, riprodhimit, përshtatjes, publikimit dhe shpërndarjes së çfarëdo gjëje ose pjesë të tyre.

NENI X

STATUSI I IOM-IT

Gjithçka që përbëhet ose është në lidhje me këtë Memorandum nuk do të konsiderohet si heqje dorë, e shprehur ose e nënkuptuar, nga cilido privilegj dhe imunitet që i posedon IOM-i si një organizatë ndërqeveritare

NENI XI

ZHGJIDHJA E KONTESTEVE

1. Çdo kontest, çështje ose kërkesë kontroverze që del në lidhje me këtë Memorandum, ose në lidhje me shkeljen, ndërprerjen ose pavlefshmërisë së Memorandumit, do të zgjidhet me anë të negociimit miqësore ndërmjet Palëve.
2. Çdo kontest, çështje ose kërkesë kontroverze që nuk është zgjidhur me anë të negociatave miqësore në afat prej 3 (tre) muajve nga pranimi i njoftimit nga njëra palë për ekzistencën e një kontesti, çështje apo kërkesë kontroverze të tillë, secila nga Palët mund të kërkojë që kontesti, çështja apo kërkesa kontroverze të zgjidhet me anë të pajtimit nga ana e njërit ndërmjetësit në përputhje me Rregullat e Pajtimit UNCITRAL të vitit 1980. Neni 16 i Rregullores së Pajtimit të UNTRICAL nuk zbatohet.
3. Në rast se një pajtim i tillë është i pasuksesshëm, secila Palë mund të paraqesë kontestin, çështjen kontroverze ose kërkesën në arbitrazh jo më vonë se 3 (tre) muaj pas datës së përfundimit të procedurave të pajtimit sipas Nenit 15 të Rregullave të Pajtimit UNCITRAL. Arbitrazhi do të kryhet në përputhje me rregullat e arbitrazhit 2010 UNCITRAL të miratuar në vitin 2013. Për arbitrazhin do të ketë vetën një arbitër dhe gjuha e procedurave të arbitrazhit do të jetë anglisht, përveç nëse Palët me marrëveshje në formë në letrës bien dakord ndryshe. Gjyqi i arbitrazhit nuk ka asnjë autorizim për të dhënë dëshmipërblime ndëshkuese. Vendimi i arbitrazhit do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm.
4. Për këtë Memorandum si dhe për marrëveshjen për arbitrazh, të përmendur më lartë, do të zbatohen kushtet e caktuara me këtë Memorandum dhe të plotësuara nga parimet e përgjithshme juridike të pranura ndërkombëtare, që nuk mbulohen nga ky memorandum, duke përjashtuar çdo sistem juridik kombëtar që kompetenca e Memorandumit do të shtynte drejt rregulloreve pozitive ligjore në çfarëdo juridiksioni. Parimet e përgjithshme juridike ndërkombëtare do të vlerësohet të përfshijnë edhe parimet e UNIDROIT për Marrëveshje Ndërkombëtare Tregtare. Zgjidhja e kontesteve do të zbatohet në mënyrë konfidenciale nga të dy Palët. Ky nen vlen edhe pas skadimit ose përfundimit të këtij Memorandumi.

NENI XII

HYRJA NË FUQI, NDRYSHIMET DHE KOHËZGJATJA

1. Ky Memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dy palëve. Me hyrjen në fuqi, Palët do t'ia bëjnë të ditur Memorandumin personelit që punon në terren dhe në zyrat qendrore.
2. Ky Memorandum mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të dorëzohen me shkrim nga njëra Palë dhe do të hyjë në fuqi pas pranimit të saj me shkrim nga të dy Palët.
3. Secila nga palët mund ta përfundojë këtë Memorandum duke i dhënë njoftim me shkrim Palës tjetër për përfundimin në periudhë pre 6 (gjashtë) muaj.

NË DËSHMI TË SA ME SIPËR, poshtë të nënshkruarit, përkatësisht Ministri si përfaqësues i Qeverisë dhe përfaqësuesi i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin e nënshkruajnë këtë Memorandum.

Memorandumi bëhet në dy versione origjinale në anglisht dhe maqedonisht, Në rast të mospërputhjes së të teksteve, version në anglisht do të vlerësohet si i vlefshëm.

Për

Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut
Nënshkrimi

Për dhe në emër të

Organizatës Ndërkombëtare për Migracion
Nënshkrimi

Edmond Ademi

Ministër pa Resor i angazhuar për Diasporën

Më datë 13.05.2019

Vendi: Shkup

Argentina Sabados

Drejtorsha Rajonale për Evropën Juglindore,
Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore

Më datë: 13.05.2019

Vendi: Shkup